

**VENDIM**  
**Nr.1245, datë 10.9.2008**

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT, TË CIKLIT TË DYTË, PRANË  
UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS, NË VITIN AKADEMIK 2008-2009**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Hapjen, pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në Fakultetin e Gjeologjisë dhe Minierave, të programeve të mëposhtme të studimit, të ciklit të dytë:

a) Programi i studimit “Inxhinieri gjeologjike”, me profile:

- Gjeologji inxhinierike dhe hidrogeologji;
- Vendburimet e mineraleve të dobishme-petrologji;
- Gjeologji e vendburimeve hidrokarbure;
- Gjeoinformatikë.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili gjeologji inxhinierike dhe hidrogeologji;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili vendburimet e mineraleve të dobishme-petrologji;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili gjeologji e vendburimeve hidrokarbure;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeologjike, profili gjeoinformatikë.

b) Programi i studimit “Inxhinieri e burimeve natyrore”, me profile:

- Inxhinieri e burimeve të energjisë;
- Përpunim mineralesh dhe mbetjesh;
- Gjeomatikë;
- Gjeoinxhinieri.

Në përfundim të këtij programi do të lëshohen diplomat e mëposhtme:

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili inxhinieri e burimeve të energjisë;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili përpunim mineralesh dhe mbetjesh;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili gjeomatikë;

- Diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e burimeve natyrore, profili gjeoinxhinieri.

c) Programi i studimit “Inxhinieri gjeofizike”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinieri gjeofizike.

ç) Programi i studimit “Inxhinieri e gjeomjedisit”, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e nivelit të dytë, DND, në inxhinierinë e gjeomjedisit.

2. Programet e studimeve të ciklit të dytë realizohen me 120 kredite dhe zgjatja normale e tyre është dy vite.

3. Këto programe studimi të fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2008-2009.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2008, miratuar për Universitetin Politeknik të Tiranës.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Universiteti Politeknik i Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**